



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raport Mujor - Prill 2008

Përmbledhje

Raporti nënvizon shkeljet e ligjit vendor dhe standardeve për të drejtat e njeriut. Pjesa penale fokusohet në dështimin e prokurorëve të hetojnë dhe të ndjekin penalisht përdorimin e pajustificueshëm të forcës nga ana e zyrtarëve të policisë (mbase duke shkelur kështu të drejtën për dinjitet), përderisa pjesa civile fokusohet në dështimin e gjykatave për të kontaktuar organin kompetent administrativ ose për të përdorur mjete alternative për t'i alokuar të paditurit (mbase duke shkelur kështu të drejtën për gjykim korrekt).

Dështimi i prokurorëve të hetojnë dhe të ndjekin penalisht përdorimin e pajustificueshëm të forcës nga ana e zyrtarëve të policisë mund të shkel të drejtën për dinjitet

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) është i brengosur se prokurorët nuk kanë hetuar pohimet e pandehura se zyrtarët e policisë kanë përdorur forcë të panevojshme ndaj të pandehurve gjatë arrestit dhe qëndrimit në paraburgim.

Sipas Gjykatë Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut çfarëdo drejtimi i dhunës kundër personit të privuar nga liria e tij/saj (që nuk është bërë domosdoshmërisht e nevojshme për shkak të sjelljes së të paraburgosurit) “përl dinjitetin e njeriut”,¹ dhe si e tillë shkel nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.² Veç kësaj, çfarëdo dëmtimi ndaj integritetit fizik gjatë mbajtjes në polici është *prima facie* përgjegjësi e autoriteteve shtetërore.³

Pohimet e pandehura lidhur me abuzimin nga ana e policisë duhet të hetohen. Në të kundërtën, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut së fundi ka deklaruar se, “ndalimi i përgjithshëm ligjor i torturës, trajtimit johuman e degradues dhe ndëshkimit, përkundër rëndësisë fundamentale, do të jetë joefektive në praktikë dhe në disa raste do të jetë e mundshme për agjentët e Shtetit që me mosndëshkim virtual të abuzojnë me të drejtat e atyre që i kanë nën kontroll.”⁴

Megjithatë, OSBE ka monitoruar raste në të cilat policia pandehet se kishte keqtrajtuar të pandehurit, ndërsa prokurorët dështuan t'i hetojnë pohimet e tilla:

Në një rast pranë një Gjykate Komunale dy të pandehur u përballën me akuza të vjedhjes së rëndë⁵ dhe pranimi të gjësendeve të vjedhura.⁶

¹ Shih *Tekin kundër Turqisë*, 22496/93, Aktgjykim, 9 qershor 1998, paragrafi 53; *Ribitsch kundër Austrisë*, 18896/91, Aktgjykim, 4 dhjetor 1995, paragrafi 38.

² Neni 3 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut thotë: “Askush nuk do të jetë objekt i torturës ose trajtimit degradues dhe johuman ose ndëshkimit”

³ Shih *Bati e të tjerë kundër Turqisë*, A. 33097/96 dhe 57834/00, Aktgjykim, 3 qershor 2004, paragrafët 136 dhe 138.

⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Dzeladinov dhe të tjerë kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë* 13252/02, 10 prill 2008, paragrafi 69. Sipas Gjykatës, “Kur një individ shpreh pohim të besueshëm se ai ka vuajtur nga trajtimi që shkel nenin 3 në duar të policisë ose agjent tjerë të ngjashëm të Shtetit, ajo dispozitë lidhur me obligimin e përgjithshëm të Shtetit sipas neni 1 të Konventës për ‘t’i siguruar çdonjërit brenda juridiksionit të vet të drejtat dhe liritë e definuara [në] Konventë’, kushtëzon ndërhyrjen që të ketë hetim zyrtar efektiv”, i cili duhet të jetë “i plotë” dhe “ekspeditiv” (*Id.*, paragrafët 69-71).

⁵ Neni 253(1)(1), Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/25, 6 korrik 2003 (“Kodi Penal”).

Gjatë hetimeve, njëri nga të pandehurit pranoi pranë policisë se ishte fajtor për veprat e pandehura penale. Megjithatë, në seancën gjyqësore të 18 majit 2007, i pandehuri deklaroi se policia, duke e sulmuar fizikisht e kishte detyruar atë t'i pranoj veprat.⁷ Me gjasë, gjatë qëndrimit në paraburgim, dy policë e goditën atë në kokë me shkopinj të hekurt, duke rezultuar me lëndime të mëdha që i shkaktuan atij humbje të vetëdijes për katër orë. I pandehuri i dha emrat e policëve dhe ofroi që ta plotësoj pohimin e tij me raport mjekësor. Deri më sot, prokurori publik nuk ka filluar hetimet kundër këtyre policëve.

Në një rast tjetër pranë një Gjykate Komunale ku përfshiheshin akuza për sulm ndaj personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare⁸, i pandehuri pohoi dhe ofroi prova për përdorim të pajustificueshëm dhe të tepruar të forcës nga ana e policëve derisa kryenin bastisjen e shtëpisë e më pas edhe gjatë mbajtjes në paraburgim. I pandehuri pohoi se gjatë arrestimit në shtëpinë e tij policët e sulmuan atë fizikisht aq rëndë sa që ai humbi vetëdijen dhe kishte nevojë për hospitalizim po të njëjtën ditë. Ai gjithashtu pohoi se policët e rrahën atë derisa ishte në veturën e policisë e po ashtu edhe kur mbahej në paraburgim në stacionin policor. I pandehuri i prezantoi gjykatës fotografi dhe raport mjekësor si dëshmi të keqtrajtimit. Me 30 janar 2008, kryetari i trupit gjykues e shpalli të pandehurin fajtor dhe e dënoi atë me tre muaj burg. Vlen të ceket se, në aktgjykim gjykata morri parasysh si rrethana lehtësuese për të pandehurin “*lëndimet e pranuar dhe përkeqësimin e shëndetit të të akuzuarit.*” Nuk ka pasur hetime prokuroriale për pohimet lidhur me abuzimin e policisë.

Në të dy rastet e përshkruara më lartë, të pandehurit kanë pohuar se policia i kishte keqtrajtuar duke i shkelur atyre të drejtën për dinjtet. Si shqetësim, OSBE-ja beson se as policia e as prokuroria nuk kanë hetuar incidentet e pandehura, duke shkelur detyrën për të zbatuar përkushtim të duhur në hetimin, mbrojtjen dhe dënimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut.⁹

Rrjedhimisht, pozicioni i OSBE-së është se:

- Zyrtarët e Shërbimit Policor të Kosovës duhet t'i shmangen përdorimit të forcës ndaj të pandehurve, përpos në rastet kur kjo është e domosdoshme.
- Prokurorët duhet të hetojnë shpejt dhe, nëse është e duhur, të ndjekin penalisht me përkushtimin e duhur policët të cilët me gjasë keqtrajtojnë ose përdorin forcë të tepruar ndaj të pandehurve.

⁶ Neni 272(1), Kodi Penal.

⁷ Vlen të ceket se, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale në Kosovë parasheh se “nga i pandehuri ose personi tjetër që merr pjesë në procedurë ndalohet dhe dënohet që të imponohet pranimi i fajësisë ose ndonjë deklaram tjetër me anë të torturës, forcës, kanosjes apo nën ndikimin e drogës ose të masave të tjera të ngjashme” (Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003, Neni 11(3)).

⁸ Neni 317, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale.

⁹ Komisioni i KB-ve për të Drejtat e Njeriut, Koment i Përgjithshëm nr. 31, *Natyra e Obligimit të Përgjithshëm të Vendosur mbi Shtetet Palë të Konventës*, 26 maj 2004 (CCPR/C/21Rev.1/Add.13), paragrafi 8.

- Shërbimi Policor i Kosovës duhet të inicioi hetim të brendshëm dhe nëse është e duhur, edhe procedura disiplinuese kundër policëve të cilët me gjasë përdorin dhunë të tepërt dhe joligjore në punën e tyre.
- Rekomandohet që Instituti Gjyqësor i Kosovës t'i trajtoj prokurorët dhe gjyqtarët mbi të drejtat e personave të arrestuar, me fokus në keqtrajtimin e pandehur gjatë mbajtjes në paraburgim policor.

Dështimi i gjykatave për të kontaktuar organin kompetent administrativ ose për të përdorur mjete alternative për t'i alokuar të paditurit shkel ligjin vendor e mbase edhe të drejtën për gjykim korrekt

OSBE-ja është e brengosur se dështimi i gjykatave që të veprojnë në pajtueshmëri me ligjin vendor kur caktojnë përfaqësues të përkohshëm mund të qoj në shkelje të së drejtës së paditësit për gjykim korrekt. Duke mbajtur gjykime pa pjesëmarrjen dhe dijen e të paditësve, personave të përfshirë nuk u jepet mundësia ta prezantojnë rastin e tyre, mbase duke shkelur kështu parimin e barazisë së armëve.

Parimi i barazisë së armëve është një aspekt i rëndësishëm i së drejtës për gjykim korrekt. Në bazë të këtij parimi, palës “duhet t'i ofrohet mundësi e arsyeshme për të prezantuar rastin e tij/saj para gjykatës, nën kushtet të cilat nuk e vendosin atë në pa-barazi thelbësore *vis-à-vis* kundërshtarit të tij/saj.”¹⁰

Ligji i aplikueshëm i procedurës civile kërkon që “[g]jykata do t'i ofroj secilës palë mundësinë që të shprehet lidhur me paditë dhe deklaratimet e palës kundërshtarë.”¹¹ Për më tepër, ligji i procedurës civile parashih mundësinë e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm në rastet kur vendqëndrimi i tij/saj nuk është i njohur dhe ai ose ajo nuk ka përfaqësues, dhe në qoftë se procedura e rregullt do të merrte shumë kohë duke shkaktuar kështu pasoja të dëmshme për njërin ose të dy palët.¹²

Siç është nënvizuar në raportin e mëparshëm tematik të OSBE-së mbi *Caktimin e Përfaqësuesve të Përkohshëm për Kontestet Pasurore Juridike ku si Palë të Paditura janë Pjesëtarët e Pakicave* (prill 2005), caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm është i paraparë si mjet i fundit. Ligji gjithashtu vendos obligim mbi gjykatën që të bëjë kërkimin e të paditësit në mënyrë proaktive: “[n]ëse pala nuk mund ta gjej adresën e personit të cilit duhet t'i dërgohet shkresa [...] gjykata do të tentoj të merr informacionin e nevojshëm nga organi kompetent administrativ, ose të merr informacionin e duhur në ndonjë tjetër mënyrë.”¹³

Andaj, gjykatat janë të autorizuar dhe të kushtëzuara të përdorin mjete e arsyeshme në dispozicion në rastet civile për të alokuar të paditurin që mungon. Regjistri Qendror Civil në thelb përfaqëson “organin kompetent administrativ” të paraparë në Ligjin mbi

¹⁰ Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Beheer kundër Holandës*, 14448/88, Aktgjykim, 27 tetor 1993, paragrafi 33-34.

¹¹ Shih nenin 5, Ligji mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77–1478, e ndryshuar me 15/1998).

¹² Shih nenin 84 Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

¹³ Neni 148, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

Procedurën Kontestimore.¹⁴ Veç kësaj, organi adekuat për të ftuar palët që janë jashtë Kosovës është Departamenti i Drejtësisë.¹⁵ Për më tepër, ka edhe mjete tjera të mundshme për të alokuar të paditurit që mund të jenë zhvendosur, siç janë zyrat regjionale dhe/ose qendrore të Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, zyrat ndërlidhëse të gjykatave¹⁶, ose zyrën e UNMIK-ut për Kthim dhe Komunitete.

OSBE-ja më parë ka vërejtur dështimin e disa gjykatave për të përdorur organin kompetent administrativ ose, kur është e nevojshme, mjetet e arsyeshme alternative për të alokuar të paditurit.¹⁷ Që nga publikimi i këtij raporti në vitin 2005, OSBE-ja ka monitoruar pajtueshmërinë e gjykatave me obligimin e tyre për të alokuar palët në mungesë. Rastet në vazhdim shërbejnë si shembuj:

Në një rast pranë një Gjykate Komunale, paditësi shqiptar i Kosovës pohoi se kishte blerë pronën e kontestueshme para 30 vjetëve nga të paditurit serbë të Kosovës të cilët me gjasë kanë lëshuar Kosovën në adresë të panjohur. Për të gjetur adresën e të paditësve, gjykata kontaktoi me zyrën ndërlidhëse por jo edhe me Departamentin e Drejtësisë.¹⁸ Gjykata caktoi përfaqësuesin e përkohshëm më 27 mars 2008.

Sa i përket një rasti pronësor pranë një Gjykate Komunale, një paditës shqiptar i Kosovës kërkoi vërtetimin e posedimit të pronës së tij të cilën kinse babai i tij e kishte blerë para 40 vjetëve nga një serb i Kosovës (i padituri i dytë) i cili me sa duket e kishte blerë atë nga një tjetër serb i Kosovës (i padituri i parë). Pa asnjë përpjekje për të alokuar të paditurin e parë, më 27 dhjetor 2007, gjykata pas propozimit të paditësit caktoi përfaqësuesin e përkohshëm për të.¹⁹ Dy seanca tjera ishin mbajtur më 23 janar dhe 7 shkurt 2008 pa prezencën, dhe sigurisht edhe pa dijeninë e të paditurit të parë.²⁰

Në një rast të tretë pronësor pranë një Gjykate Komunale, paditësit shqiptarë të Kosovës parashtruan padi ku përfshihej një i paditur serb i Kosovës në seancën gjyqësore të datës 21 shtator 2007. Në seancën e njëjtë, gjykata vendosi që të caktoj përfaqësues të përkohshëm pa asnjë

¹⁴ Nën Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2002/16 që implementon Rregulloren e UNMIK-ut 2000/13 mbi Regjistrin Qendror Civil, autoritetet gjyqësore të UNMIK-ut mund të kërkojnë zbulimin e të dhënave personale nga Regjistri Qendror Civil për t'i alokuar personat që mungojnë.

¹⁵ Departamenti i Drejtësisë, Qarkorja e Drejtësisë 2003/03, *Ndihma Ligjore Ndërkombëtare në Rastet Civile dhe Penale*, 5 shtator 2003.

¹⁶ Megjithatë, që nga deklarimi i pavarësisë nga Parlamenti i Kosovës, zyrat ndërlidhëse anembanë Kosovës (përgjegjëse për lehtësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet jo-shqiptare) ndaluan punën e tyre. Siç është raportuar, anëtarët e komunitetit serb të Kosovës kanë shtyrë punonjësit e zyrave ndërlidhëse të gjykatave të mos punojnë për Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës së pavarur.

¹⁷ Raporti tematik i OSBE-së, mbi Caktimin e Përfaqësuesve të Përkohshëm për Kontestet Pasurore Juridike ku si Palë të Paditura janë Pjesëtarët e Pakicave, prill 2005, faqet 2-3.

¹⁸ Punonjësit e gjykatave i thanë OSBE-së se ata nuk kontaktojnë më me Departamentin e Drejtësisë pasi që ata zakonisht nuk marrin përgjigje nga Departamenti i Drejtësisë me kërkesë të gjykatës. Ata shprehen dyshime se autoritetet serbe bashkëpunojnë me Departamentin e Drejtësisë.

¹⁹ Vlen të ceket se, paditësi gjithashtu deklaroi se ai do të paguajë shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, që qon në konflikt të mundshëm interesash.

²⁰ Me 7 shkurt 2008, gjykata aprovoi kërkesën e paditësit.

përpjekje për ta alokuar atë. Një tjetër seancë ishte mbajtur me 4 dhjetor 2007.²¹

Dështimi i disa gjykatave për të bërë përpjekje të arsyeshme mund të lë të paditurit në padijeni për procedurat gjyqësore kundër tyre. Pasi që përfaqësuesit e përkohshëm nuk takohen me klientët e tyre, ata kanë vështirësi për të prezantuar dëshmi ose t'i mbrojnë në mënyrë adekuate interesat e të paditurit pranë gjykatës. Andaj, të paditurit që mungojnë nuk kanë mundësi të arsyeshme t'i prezantojnë rastet e tyre, dhe si rrjedhojë gjenden në mos-barazi *vis-à-vis* kundërshtarit të tij/saj. Kështu, në shumë raste të këtilla gjykatat shkelin parimin e barazisë së armëve. Veç kësaj, duke dështuar të përdorin mjete të arsyeshme alternative për të alokuar të paditurit, gjykatat shkelën rregullat procedurale për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm.²²

Për atë çka u tha më lartë, pozicioni i OSBE-së është se:

- Gjyqtarët duhet të kontaktojnë organin kompetent administrativ ose të përdorin mjete të arsyeshme alternative për të alokuar të paditurit që mungojnë para se të caktojnë përfaqësuesin e përkohshëm.
- Rekomandohet që Instituti Gjyqësor i Kosovës të mbaj trajnime në atë mënyrë që të gjithë gjyqtarët civil t'i kuptojnë procedurat që duhet t'i përcjellin, përfshirë këtu caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm kur përballen me të paditurit që mungojnë.
- Njësitë për Inspektim Gjyqësor duhet të hetoj rastet në të cilat përfaqësuesi i përkohshëm është caktuar parakohshëm.

²¹ Në po të njëjtën datë, gjykata aprovoi padinë e paditësit. Shqetësuese është se, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit jo vetëm që ishte pasiv gjatë procedurës, por edhe propozoi që gjykata ta aprovoi padinë si të bazuar - që është në kundërshtim me interesat e klientit të tij.

²² Vendimi për të caktuar përfaqësues të përkohshëm nuk ka cekur pasojat e dëmshme për palët në qoftë se nuk caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, siç kërkohet me ligj. Veç kësaj, në disa raste, vendimi për të caktuar përfaqësues të përkohshëm publikohet vetëm në gazetë ditore të Kosovës në gjuhën shqipe, të cilën nuk ka gjasa që ta lexojë një serb i Kosovës.